



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 20 korrik 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Muhamet Mustafa.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Ismet Krasniqi –Kuvendi i Republikës së Kosovës, Rrahman Paçarizi –RTK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri – koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës), Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.
5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për importim, blerje vendore dhe shkëmbime të energjisë elektrike nga KEK-u gjatë vitit 2010.
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në bazë të nenit 64 të Rregullores së Kuvendit shqyrtimi i pikës tre dhe pesë i rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit. Po ashtu propozoi që në rend

dite të përfshihet edhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 13 korrik 2011.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.07.2011,

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.07.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari – Opinioni i ZAP-it lidhur me pasqyrat e audituara financiare për Administratën e Kuvendit është “Opinion i pakualifikuar”. Dy nga rekomandimet e vitit paraprak nuk janë adresuar fare lidhur me këtë, kërkoj sqarim si nga sekretari i Kuvendit ashtu edhe nga ZAP-i, sepse të dy këto rekomandime janë shumë të përgjithësuara. Pastaj, tri rekomandime janë në proces të adresimit. 54% e buxhetit kapital është shfrytëzuar vetëm në muajin dhjetor, pse ka ndodhur kjo? Përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre operatorëve të përgjegjshëm, ka mospërputhje në mes të çmimit dhe kontratës, dobësi në vlerësimin e ofertës, mungesa e zyrtarit të pasurisë gjatë vitit 2010, sistemi i kontrollit të brendshëm. Këto janë çështjet për të cilat Komisioni kërkon sqarime.

Valbona Dibra – Përgëzoi Administratën e Kuvendit për opinionin e pakualifikuar që do të thotë se puna në këtë institucion është kryer në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse nuk ka perfeksion. Ekziston Udhëzimi Administrativ lidhur me mëditjet në rastet kur shpenzimet e udhëtimit hiqen nga organizatori. Pyeti: a është marrë vendim nga Kryesia e Kuvendit lidhur me këtë çështje, apo veprohet në bazë të këtij udhëzimi?

Armend Zemaj – Rekomandimet e auditorit dhe zotimi i sekretarit për thirrje në përgjegjësi për ata të cilët nuk kanë kryer punën mirë tregon për një efikasitet në punë. Të gjeturat nuk kanë ndikim material, por fusha e prokurimit ka pengesa në cilësinë e menaxhimit, sepse ka të gjetura teknike dhe kjo ka të bëjë me punë profesionale. Partitë politike nuk kanë raportuar gjatë periudhës tre mujore. A kanë dorëzuar edhe partitë tjera politike raportet dhe si planifikon Administrata e Kuvendit që këto parti të cilat nuk kanë raportuar t'i vejë para përgjegjësisë? Pse të mos bëhet një deklaram publik se cilat parti nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor. Ndoshta përqendrimi i auditorit të brendshëm në fushën prokurimit për vitin aktual, e jo për vitin paraprak, do të eliminonte të gjeturat në prokurim. Sa janë duke arritur që të përcillen të gjeturat e auditorit?

Murselj Haljilji – Administrata e Kuvendit ka bërë një punë të mirë. Është çështje e partive politike që të raportojnë sipas marrëveshjes. Është indikative dhe e nevojshme që të ketë raport nga partitë dhe ndoshta do të duhej të theksohej se cila nga partitë ka raportuar e cila jo.

Afrim Hoti – Çështja e furnizimit me kombibus dhe lloptop nuk është zgjidhur dhe lenë një përshtypje për keqpërdorim. Kur do të zgjidhet kjo çështje?

Alma Lama – Pyeti: a janë bërë pagesat edhe për partitë të cilat nuk kanë dorëzuar raportet tremujore, meqenëse ligji thotë që për partitë të cilat nuk dorëzojnë raportet tremujore nuk bëhen pagesat. Po ashtu kërkoj sqarim edhe nga auditori lidhur me “*sqarimin e informatave të furnizimi me kompjuter*”. Në Kosovë vërehet fenomeni që të njëjtit njerëz konkurrojnë me dy firma. A është prezent ky fenomen në Kuvend?

Bezat Halilaj - ZAP- Tha se ka pas raste kur administrata ka paguar pa e përputhur si duhet pagesën me faturat dhe pagesat janë bërë jo në përputhje me specifikacionin. Kjo ka qenë arsyeja e rekomandimit të parë të pa adresuar nga Kuvendi në vitin e kaluar.

Rekomandimi i dytë – ka të bëjë me prokurimin. Raporti flet se në shumë raste në procedurat e prokurimit janë përsëritë parregullsitë e vitit të kaluar, domethënë të gjeturat si rezultat i moszbatimit të këtyre rekomandimeve janë përsëritë edhe këtë vit. Pjesa më e madhe e shpenzimeve përjashtuar kategoria paga dhe mëditje kalojnë përmes procesit të prokurimit – në të gjitha raportet e OB –ve do të vërejmë çështje të cilat ndërlidhen me parregullsitë në procesin e prokurimit.

Armend Zemaj – Kërkoj sqarim lidhur me pjesën e dytë të rekomandimit të parë “ *nën kriteret të peshohen dhe vlerësohen drejtë*”.

Bezat Halilaj - Disa prokurime janë përsëritur, sepse nuk janë zbatuar kriteret dhe kjo ka sjellë deri te e gjetura se rekomandimet nuk janë adresuar.

Ismet Krasniqi – Puna e ZAP- it obligon dhe e bënë më përgjegjës Administratën e Kuvendit për të eliminuar lëshimet eventuale. Buxheti te investimet kapitale- përgatitja e tenderëve me vlera të mëdha merr kohë dhe kjo pastaj reflektohet në shpenzimin në muajt e fundit të vitit. Janë të shpeshta rastet e anulimit të tenderëve, kjo si pasojë e mungesës së ofertuesve të përgjegjshëm, por edhe operatorët ekonomikë nuk janë shumë të interesuar që të aplikojnë në pjesën e parë të vitit. Do të bëhen përpjekje që shfrytëzimi i buxhetit për investime kapitale të bëhet proporcionalisht gjatë vitit, por e njoftoj Komisionin se edhe gjatë vitit 2011 kjo do të përsëritet, sepse buxheti është miratuar në fund të muajit mars, pastaj kanë shkuar edhe disa muaj për përgatitjen e specifikacioneve etj.

Çështjet e prokurimit -nuk ka të bëjë me keqpërdorime dhe keq menaxhim, por në shumicën e rasteve ka të bëjë me lëshime teknike, të cilat nuk kanë reflektuar për shmangie nga procedurat. Nuk ka pasur asnjë ankesë nga operatorët ekonomik. Çështja e furnizimit me kombibus ka qenë problematikë e veçantë dhe e gjetura se ka munguar certifikata e lëshuar nga gjykata, por e vërtetuar nga Komuna. Komisioni vlerësues ka marrë për bazë vulën e komunës dhe kjo nuk e ka dëmtuar procesin në vlerësimin e ofertave. Lidhur me këtë nuk ka pasur ankesë.

Dobësi në vlerësimin e ofertave, mungesa e procesverbalit për rrjedhën -kjo nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Mungesë të zyrtarit të pasurisë – ka ekzistuar zyrtari i pasurisë, pastaj ai zyrtar ka kaluar në Divizionin për mbështetje të komisioneve. Është bërë shpallja e konkursit lidhur me këtë dhe deri në përzgjedhjen e zyrtarit të ri, zyrtari aktual është ngarkuar me punë shtesë.

Regjistrimi i pasurisë - është bërë dhe është evidentuar.

Menaxhimi i kontrollit – përpjekjet janë të vazhdueshme për të bërë një punë të mirë. Por, edhe të gjeturat e ZAP-it janë të përgjithësuara dhe përderisa janë kështu nuk mund të jenë në ngritjen e përgjegjësisë eventuale. Auditori i brendshëm - thuhet ka kryer, por nuk ka kryer auditime, cila nga kjo është e gjetur. Auditori i brendshëm ka kryer pesë auditimet e planifikuara. *Çështja e mëditjeve* – që ka mbetur e pa-adresuar nga viti i kaluar - Kuvendi ka nxjerrë vendim që mëditjet paguhen 30% për rastet kur organizatori heq shpenzimet e tjera.

Çështja e raportimit të partive politike për mjetet e shpenzuara është problem që administrata nuk ka mundur të ndjekë. Deri në muajin nëntor dy parti të cilat kanë raportuar për mjetet e shpenzuara janë PDK dhe GIG.

Në vitin 2006 Kuvendi ka pasur 4 000 euro para të gatshme të shpenzuara. Në vitin 2010 janë shpenzuar 2000 euro, domethënë Administrata ka arritur të zvogëlojë shpenzimin në para të gatshme.

Çështja e kombibusëve tri herë është anuluar tenderi, një herë jemi manipuluar nga operatorët, ndërsa çështja e llatopëve në specifikacionin e kompanisë që ka fituar tenderin ka pasur pësëfishin e buxhetit dhe në bazë të kësaj Komisioni e ka vlerësuar tenderin.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari - Opinioni është i pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas këtij material kuptohet se ka një rekomandim që të sigurohet një shikim i kontrollit të brendshëm ekzistues, duhet të krijohet një mjedis i kontrollit të brendshëm, RTK për vitin kalendarik 2009 ka bërë një auditim nga një kompani private dhe ka qenë çështje që është diskutuar shumë dhe po vërehet që në të njëjtën kohë të bëhet edhe një auditim nga zyra e auditorit gjeneral. Sipas këtij raporti vërehet se RTK nuk kishte një adresim të kënaqshëm të rekomandimeve, bordi i RTK-së nuk kishte ndërmarrë të gjitha masat lidhur me delegimin e detyrave të personat përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve ku 2 ishin adresuar, 5 ishin në proces dhe 1 nuk ishte adresuar. Në pjesën e rekomandimeve të shqyrtuara aty ku flitet për borxhin, kërkesat e RTK-së në raport me KEK-un kërkoj sqarim, sepse është e përgjithësuar shuma 38 milionë nuk figuron. A është kjo shumë si kërkesë apo një pjesë është paguar, çfarë gjendje është? Buxheti i shpenzimeve në krahasim me buxhetin e aprovuar gjithsej të hyrat, pozicioni i vitit 2009 krahasuar me vitin 2010 ka një rritje shumë të lartë. Borxhet e këqija - cilat janë ato borxhe dhe çfarë plane keni për ato? Llogarit e pa pagueshme dhe të tjera është një zvogëlim i theksuar në raport me vitin 2009, cilësia e informatave, pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e menaxhmentit, pasqyrat e shpalosura nuk janë të qarta, kontrolli i pamjaftueshëm në evidentimin dhe monitorimin e të hyrave nga marketingu. Emisionet, kush do të bëhet milioner dhe emisioni “Oxygen” ka disa të gjetura rreth mënyrës së trajtimit të reklamës. Blerjet përmes prokurimit furnizimi me kasetë, shkeljet e kushteve të kontratës të emisioni “Jeta në Kosovë”. Çështja e personelit, pozita e menaxherit të prokurimit nuk ishte plotësuar për afër tri vjet. RTK ka pasur konkurs, ndër konkurruesit ka qenë edhe personi i cili ka qenë ushtrues detyre që tri vjet, janë dy raste ku Bordi nuk ka aprovuar një Rregullore dhe një Plan Pune të një softueri nuk i ka pranua dhe vazhdohet pa program pune. Evidenca e pasurisë është një problem shumë thelbësor dhe ndoshta është thelbi që nuk mund të kemi besueshmëri të plotë në raport, ngase evidentimi i pasurisë nuk është i përfshirë, në modulën e pasurisë së RTK-së kishte të evidentuar 2319 pasuri sipas sasisë dhe janë të evidentuar vetëm 991 dhe është regjistruar për 43 %, pasuria nuk është ngarkuar te zyrtarët përgjegjës të asaj pasurie që operojnë me ta, e tërë pasuria është regjistruar në emër të drejtorit të përgjithshëm. RTK ka pasur ndëshkime në raport me obligimet që nuk i ka kryer me kohë. RTK kishte pranuar një faturë në vlerë prej 4 000 euro për realizimin e emisionit pa rrotulla për muajin dhjetor dhe këtë vlerë e kishte prezantuar si obligim në regjistrin e saj kontabël, kontrata për këtë emision kishte përfunduar në muajin nëntor. RTK ka vetëm një auditorë, nuk ka Njësinë Qendrore të Auditimit të brendshëm. Çfarë janë planet tuaja rreth kësaj çështje. Kërkoj sqarim lidhur me këto të gjetura.

Valbonë Bytyçi- Për vitin 2009 fillimisht është planifikuar auditimi për Pasqyrat Financiare të RTK-së. Kuvendi ka kërkuar që të bëhet auditimi i Pasqyrave Financiare nga një auditor i jashtëm i pavarur. ZAP nuk ka pasur të drejtë për vazhduar auditimin e Pasqyrave Financiare dhe ka ndërruar objektivin e auditimit. Objektivi ka qenë implementimi i rekomandimeve të auditimit nga raporti i auditorit i vitit 2008. Në raportin e vitit 2009 të zyrës së auditorit nuk ka pasur opinion, mirëpo vetëm janë konstatuar se cilat rekomandime janë implementuar. Nuk mund të bëhen dy auditime për Pasqyra Financiare.

Rrahman Paqarizi- Bordi i drejtorëve të RTK e ka marrë shumë seriozisht raportin e zyrës së auditorit të përgjithshëm dhe ka hartuar edhe planin e përmirësimit për të i adresuar çështjet të cilat nuk janë adresuar. RTK e ka miratuar statutin e ri, kjo ka shkaktuar disa ndryshime të cilat reflektohen në çështjen e rritjes së kontrollit të auditimit të brendshëm. Auditori i brendshëm me

statutin e ri të RTK-së i përgjigjet bordit. Një nga rekomandimet është menaxhimi dhe monitorimi i mirë i reklamave, nëse lexohet raporti me kujdes janë marrë disa raste kur ka pasur tejkalim të kohës së reklamave ose ka pasur kohë më të shkurt të reklamave se që parashihet në kontrata me produksionet e jashtme, mirëpo kur të lexohet raporti në tërësi si total nuk ka tejkalim se ato barazohen në fund. Te çështja e monitorimit të reklamave situata tani është më e mirë, sepse edhe sipas rekomandimit të raportit të ZAP-it, RTK tani e bënë mbledhjen e reklamave me një sistem tjetër, jo përmes një agjencie të tretë, përmes shërbimit të marketingut i cili funksionon brenda RTK- së. Mjedis transparent në menaxhimin e prokurimit bazuar në kornizën e aplikueshme ligjore, është vërejtur një shkelje sidomos te pozita e menaxherit të prokurimit edhe te 2-3 raste ku janë konstatuar shkelje nga auditorët dhe bordi i RTK-së ka kërkuar nga menaxhmenti që të merren masa. Zhvillimi i regjistrimit kohor dhe kalkulim të pagave duke u bazuar në rregulloren e brendshme. Ekziston rregullorja për kalkulimin e pagave edhe të gazetarëve sipas normave të përcaktuara, ne kemi nisur zhvillimin e një sistemi alternativ për edivencim. Është një rekomandim për forcimin e raportimit të jashtëm - RTK në dy vitet e fundit ka raportuar në mënyrë të rregullt dhe sipas kërkesave të Kuvendit të Kosovës dhe adresimi i rekomandimeve në mënyrë më të organizuar. RTK është në përgatitje dhe gjatë muajit korrik bordi i RTK- së bashku me menaxhmentin do të plotësojmë planin e përmirësimit dhe do t'i dërgojë edhe auditorit të përgjithshëm. Për çështjen e borxhit me KEK-un - RTK ka bërë kalkulimin, rezultati ka dalë, por RTK nuk ka fuqi që ta shtyjë këtë çështje përpara. Këtë raport RTK e ka dorëzuar edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Për çështjen e gjetjes së zgjidhjes lidhur me financimin e qëndrueshëm të RTK-së, janë dërguar alternativat tona për financim e që janë në pajtim me praktikat më të mira të transmetuesve publik, kemi marrë edhe inpute shumë të vlefshme nga EBU.

Sylejman Shaqiri- Deri më tani auditori i brendshëm i përgjigjej drejtpërdrejt drejtorit të përgjithshëm. Është ndërruar statuti dhe tani auditori i brendshëm i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit. Tani duhet të themelohet Komiteti i Auditimit. 38 milionë të KEK-ut, prej momentit kur ka filluar të implementohet vjelja e taksës nga qytetaret përmes agjencisë të kontraktuar në këtë rast nga KEK- ku janë faturuar dyfishi i këtij 38 milionë (afër 70 milionë kanë qenë të faturuara te konsumatori). KEK-u ka inkasuar dhe i ka bartë RTK-së 38 milionë ndërkaq të faturuara dhe të pa inkasuara kanë mbetur 38 milionë. Në momentin kur Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim që të ndërpritet vjelja e taksës ka qenë kjo shifër.

Kryetari - Nga këto 70 milionë të faturuara dhe të paguara - sa është shkalla e inkasimit të RTK-së, që i ka përfunduar KEK? A ka mjete që janë në llogarinë e KEK –ut? A duhet me qenë në llogari të RTK-së, nëse po sa është ajo shumë?

Për periudhën 2003-2009 pjesa e faturuar dhe e papaguar se, me sa di unë, KEK-u bën një kontratë të re me shfrytëzuesit dhe ata janë të obliguar në një periudhë të bëjnë pagesën. A keni ju ndonjë marrëveshje që kjo pjesë e mjeteve që ka mbet t'i kaloj RTK- së.

Rrahman Paqarizi- Është e përcaktuar me kontratë që ajo pjesë e faturuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës duhet të paguhet, kjo ka qenë kërkesë e Komisionit për Buxhet dhe Financa (KBF) që RTK të nxjerrë borxhin dhe e ka bërë këtë duke e dërguar këtë në KBF.

Sylejman Shaqiri- Sistemi i faturimit ka qenë kështu, nëse konsumatori ka pasur 100 euro borxh ndaj KEK-ut dhe ka bërë pagesën prej 50 euro, automatikisht RTK-së i janë bartë gjysma e 3.5euro, nuk ka qenë e ndarë 3.5 prej borxhit të energjisë elektrike të shpenzuar, informacioni prej KEK-ut vazhdimisht ka ardhur në RTK se sa janë faturuar dhe sa janë paguar, sepse softueri ka qenë i përbashkët. Në momentin kur është ndërpre inkasimi RTK ka pasur se nga KEK janë faturuar rreth 70 milionë euro dhe deri në shtator të vitit 2009 KEK i ka borxh RTK-së 38 milionë euro. Pjesa tjetër ka mbetur e pa inkasuar. KEK-u shumë shpejt u ka zbritur konsumatorëve nga faturat e dërguara pjesën e 3.5, ku ka bërë një shkelje te kontratës. Planifikimi i mirë i shpenzimeve, sidomos i atyre nga të hyrat vetanake, në vitin 2010 ka filluar të implementohet një rregullore e Komisionit të pavarur për media për ndalimin e marketingut në RTK - nuk ka qenë e qartë se sa do të jenë të hyrat. Nga shtatori i 2009 e deri në shkurt 2010

RTK ka qenë pa financa. Kuvendi i Kosovës në muajin shkurt të vitit 2010 merr vendim që të financojë RTK-në. Zvogëlimi i të hyrave nga marketingu është si pasojë e zbatimit të rregullores së KPM-së një kohë dhe zbatimit të rekomandimit të ZAP-it për zvogëlimin e shkëmbimeve. Borxhet e këqija, nuk ka borxhe të këqija, 85% kanë qenë të hyra nga Buxheti i Kosovës, planifikimi më i mirë për të hyrat dhe shpenzimet që mos të lidhen me burimin e të hyrave vetanake. Bordi e ka shqyrtuar këtë rekomandim dhe e ka udhëzuar menaxhmentin që të hartojë një rregullore për shfrytëzimin e të hyrave vetanake. Çështja e emisionit “pa rrotulla”, emisioni nuk është transmetuar dhe nuk është paguar, ka qenë koha e fushatës zgjedhore dhe në kohën e fushatës ne i eliminojmë emisionet e caktuara për shkak të skemës zgjedhore, ka qenë një lëshim të cilin e kemi eliminuar. Çështja e tenderëve, furnizim me kaseta dhe kompjuterë - ky tender i reflekton disa probleme të cilat i sjellë Ligji i prokurimit, vendimi i Kuvendit të Kosovës për të siguruar RTK auditimin e jashtëm të pavarur, vendimi është marrë në shkurt, kurse afati i fundit ka qenë 31 marsi. Për të bërë këtë duhet të shpallet tender. Janë shqyrtuar procedurat dhe RTK ka ardhur në situatë që të veprojnë brenda orëve për të plotësuar një vendim të Kuvendit të Kosovës. Rekomandimi 5 –kërkesa e auditorit është që të draftohet udhëzues i ri i prokurimit të brendshëm dhe t’i dorëzohet Bordit për aprovim. Është nisur procedura që të hartojmë një udhëzues që do të jetë në harmoni me dispozitat e Ligjit të ri për prokurimin publik. Është vetëm një rast kur RTK ka paguar kamatë në shumë prej 700 euro, është në pyetje kompania e cila na siguron transmetimin përmes rrjetit satelitor të programit të RTK-së, problemet që i ka pasur RTK me buxhet është shkaktari kryesor pse nuk janë ekzekutuar pagesat ndaj partnerëve. Duhet të shpallet konkursi për menaxheren e prokurimit. Planin aksional do të përfundojmë deri në fund të muajit korrik dhe do të adresohen të gjitha këto rekomandime.

Ramiz Lladrovci- Opinioni i raportit është me theksim të çështjes. RTK duhet të bëjë planifikime të prokurimeve më të mira, sepse kjo vë në pah dobësitë. RTK ka blerë diku rreth 574 620 euro më shumë. Kjo është rrjedhojë e mos planifikimit të mirë, kjo pastaj flet për ata se RTK nuk e ka zgjedhur akoma menaxherin e prokurimit e që nuk ka të drejtë që të mbajë një menaxher 1 vit me kontratë mbi vepër, sepse është e ndaluar me ligj. Pastaj zyrtarin për pasuri duhet të emëroni sa më shpejt. Rreth obligimit për faturimin prej 4 000 euro për emisionin “pa rrotulla” me siguri se do të merren masa ndaj përgjegjësit financiar. Për marketing- a ka standard të caktuar apo mbas kohës kur është piku është një sekondë më shtrenjtë? Kërkoj që çmimorja të shpjegohet me në detaje.

Armend Zemaj – Propozoi që Komisioni të nxjerrë një rekomandim që për RTK-në të bëhet një auditim i performancës. Auditorit të përgjithshëm i mungojnë njohuritë për punën dhe detyrat të cilat i ka RTK-ja në tërësi. Është shumë me rëndësi që të sqarohet se çka përmban emisioni që paguhet nga taksapaguesit dhe çka i ofrohet publikut me atë emision se sa fokusimi që ka bërë auditori në auditorin e brendshëm apo mungesën e Komitetit të Auditimit? Emisionet për të cilat figurojnë të gjeturat janë pikërisht ato në cilat ka skena të tmerrshme publike. Auditori, pra është dashur më shumë të përqendrohet në cilësi. Kjo është arsyeja pse kërkoi auditim i performancës. Është e pakuptimtë që për tri vjet radhazi nuk është zgjedhur menaxheri i prokurimit. Auditori është dashur të fokusohet edhe në çështjes se në RTK punojnë nga tre e katër anëtarë të një familjeje. Në RTK ka njerëz nga brenda që përfitojnë tender. Çështja e 4 000 euro a janë kthyer ato mjete? Pastaj një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk arrijnë që të shikojnë RTK- në si pasojë e mos-mbulimit me frekuenca në gjithë territorin. Këto janë çështje që i mungojnë raportit dhe me të cilat duhet të merret bordi i ri i RTK- së.

Alma Lama – Media publike është në një pozicion jo të mirë për faktin se financohet nga Kuvendi dhe tendencat politike për ta kontrolluar janë aty. Problemi kryesor është auditimi i brendshëm. Për 12 milionë ka pasur vetëm një mostër dhe vetëm një fushë. Është dashur të bëhen se paku në tre ose katër fusha dhe disa auditime e jo një auditim siç ka ndodhur. Pse nuk ka ndodhur që të bëhen më shumë auditime dhe të merren më shumë mostra? Pozita e menaxherit të prokurimit- sa është pagesa për një rast të tillë dhe nëse kjo nuk është zgjidhur si pasojë e pagesës, pse nuk është rritur kjo pagesë meqenëse kjo do të evitonte shumë parregullsi. Çështja e reklamave – nuk janë parashikuar reklamat gjatë fushatës zgjedhore, por ka një rënie të

reklamave dhe kjo lidhet me vendimin e KPM –së i cili ka ndaluar marketingun. Sa është implementuar ky vendim dhe për çfarë periudhe kohore. KPM ka gjobitur RTK- në 150 mijë euro. Po nuk është jetësuar kjo gjobë?

Bali Muharremaj – Pyeti: a do të ketë një bilanc më të pastër sa i përket reklamave dhe si ka mundësi që në 670 punëtorë dhe mos të ketë shëf të prokurimit? A do të ketë në vitin 2011 shëf të prokurimit dhe a do të pajisen të gjithë punëtorët me kontrata të punës?

Murselj Haljilji – Për rajonin e Dragashit, në atë mjedis nuk ka sinjal që nga viti 1999. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut në atë rajon. RTK është në një situatë që një pjesë e qytetarëve edhe pse s'kanë sinjal të jenë borbë. A do të zgjidhet ky problem i borbëve të qytetarëve të Dragashit dhe si do të zgjidhet ky problem?

Afrim Hoti – Kërkoi sqarim rreth kalkulimit të pagave. Është krizë financiare për -2 milionë. A ndikon kjo në punë?

Albert Kinolli – Në secilin medium në Kosovë dikush është i favorizuar. Blerjet- thuhet të gjitha mallra dhe shërbime nuk kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit. Kërkoi sqarim lidhur me këtë. Ka mospërputhje të kohës të kontraktuar me kohën reale – pse ka ndodhur kjo? Pastaj pagesa pa kontratë valide, pasuritë dhe borbët – ka munguar rregullorja, pasuritë nuk janë të ngarkuara sipas zyrtarëve, mangësi janë vërejtur në menaxhimin e të hyrave.

Rrahman Paqarizi - Ekziston çmimorja për reklamat dhe kjo përcaktohet në bazë të kohës se kur transmetohen ato. Është mirë të bëhet edhe auditimi i performancës. Ka pas familjarizim në RTK, kjo është një situatë e trashëguar. Shikueshmëria është mirë të bëhet një hulumtim. Auditimi i brendshëm – garantoj se fokusi i Bordit do të jetë i përqendruar në këtë. Reklamat – në situatën kur RTK ka blerë një emision duke e paguar me kohë të reklamave ato janë llogaritur me çmimet reale, por nuk janë paguar me çmimet reale. Implementim i vendimit të KPM-së çështja është në gjykatë KPM ka ndërprerë reklamat në kohën kur nuk ka pasur financim nga parapagimi. Do të ketë bilanc më të pastër të reklamave. Kontratat e punës- vlerësimi i punës bëhet në fund të vitit.

Sylejman Shaqiri – Është obligim i themeluesit të RTK-s që të siguroi mbulim me sinjal të tërë territorit të Kosovës. Pika e Goleshit dhe e Svilenit janë nën menaxhimin e KFOR-it dhe deri më tani asnjë medium nuk ka pasur leje për instalimin e antenave dhe vendosjen e transmetuesit në këto dy pika.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

1. Obligohet Radiotelevizioni i Kosovës që në afatin prej tre muajve, të ndërmarrë veprime konkrete lidhur me të gjitha të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe lidhur me këtë ta njoftojë Kuvendin, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike me raport me shkrim.
2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditim të performancës së RTK-së.
3. Kuvendi i Kosovës të ketë një angazhim që t'i mundësohet RTK-së një mbulim me sinjal në tërë territorin e Kosovës.
4. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

